

Duke pasë parasysh mungesën gjithnjë më të madhe të ujit të pijes për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme që posedojmë, me qëllim të ruajtjes dhe shfrytëzimit racional të sasisë ekzistuese të ujit dhe me qëllim që ai të mjaftoj për nevojat e pijes për popullatën, në mbështetje të nenit 55 pika 19 dhe pika 20 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kryetari i Komunës së Deçanit, me dt.04.07.2012, nxjerrë këtë:

V E N D I M

MBI SHPALLJEN E GJENDJES EMERGJENTE PËR UJË TË PIJES NË TERITORIN E KOMUNËS SË DEÇANIT

I.

Shpallet gjendje emergjente për furnizim me ujë të pijes nga sistemet e ujësjellësve në tërë teritorin e Komunës së Deçanit, për periudhën kohore prej 01 Korrik 2012 deri me 15 Tetor 2012.

II.

Në periudhën kohore sa zgjatë kjo gjendje uji i pijes nuk guxon të përdoret për këto qëllime:

1. Larjen e automjeteve,
2. Larjen e trotuareve, rrugëve apo ndonjë hapësirë tjetër publike apo private,
3. Larjen e hapësirave të përbashkëta të ndërtesave, duke përfshi edhe shkallët,
4. Ujitjen e kopshteve, sipërfaqeve të gjelbëruara, bimëve, pemëve dhe drunjëve.


III.

Përfshirje nga pika II. e këtij Vendimi mund të bëhet për Ndërmarrjet për autolarje të cilat plotësojnë këto kushte:

1. Ndërmarrja që bënë kërkesën duhet të ketë të regjistruar veprimtarinë e autolarjes,
2. Të ketë të përmbushura obligimet ndaj Komunës dhe Ndërmarrjes Publike Komonale "Ujësjellësi",
3. Të jetë i kyçur në rrjetin e ujësjellësit në mënyrë legale dhe të posedoj ujëmatës i cili funksionon në mënyrë të rregullt,
4. Të paguaj një tarifë të veçantë për çdo m³ të shpenzuar të aprovuar nga Bordi Mbikqyrës i NPK "Ujësjellësi" dhe të propozuar nga Ndërmarrja Publike,
5. Të paiset me leje "për përjashtim" nga Departamenti Komunal për Shërbime Publike.

IV.

Mbikqyrjen e zbatimit të këtij Vendimi do ta bëjnë: Departamenti Komunal për Shërbime Publike, Departamenti i Inspektionit dhe NPK "Ujësjellësi" në Deçan.



V.

Për shkeljet e konstatuara nga ana e personave të autorizuar në pikën IV. Të këtij Vendimi e që kanë të bëjnë me ndalesat sipas pikës II. Do të përgjigjen dhe dënohen për kundërvajtje:

1. Personat fizik 50-100 €
2. Personat Juridik 200-400 €.

VI.

Ky vendim hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet prej dt.04 Korrik 2012, dhe në afatin e paraparë ligjorë do të njoftohet Kuvendi.

VII.

Me këtë Vendim do të njoftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Deçanit të cilët janë shfrytëzues të ujit të pijes nga sistemet e ujësjellësit në teritorin e komunës së Deçanit, përmes shpalljeve dhe formave tjera të ndryshme të informimit, si dhe organet kompetente për zbatimin e tij.

KOMUNA E DEÇANIT

02.Nr. _____

Deçan, dt.04.07.2012



Kryetari:
Rasim Selmanaj